



Raportim Vjetor

Përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë

Veprimtaria e AMF-së gjatë vitit 2013

Enkeleda Shehi, Kryetare

9 prill, 2014

Znj. Enkeleda Shehi, kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) paraqet raportin vjetor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 3 dhe nenit 28 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Kryetar i Komisionit, z. Braçe; Zëvendëskryetar i Komisionit, z. Bode; Zonja e Zotërinj deputetë anëtarë të Komisionit,

Jam sot përpara jush për të paraqitur raportin vjetor mbi veprimtarinë e AMF-së¹ të zhvilluar gjatë vitit 2013. Në fjalën time do të përqendrohem në dy shtylla kryesore: (i) stabilizimi dhe (ii) nxitja e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve, të letrave me vlerë dhe të fondeve private të pensioneve, që janë tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

¹ Raporti Vjetor, 2013, AMF.

1. Tregjet financiare nën mbikëqyrje

Tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së kanë vijuar prirjen e tyre për zgjerim. Në vitin 2013, ashtu si në vitin 2012, këto tregje kanë demonstruar një dinamikë të ndjeshme rritjeje. Për vitin 2013 (sipas vlerësimeve²) totali i aktiveve në këto tregje arriti në 73 miliardë lekë ose pothuaj dyfishi i këtij treguesi një vit më parë (37.3 miliardë lekë). Për rrjedhojë, edhe kontributi i këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar është rritur ndjeshëm. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së për vitin 2013 arriti në 5.36%, nga 2.75% që ishte në vitin 2012, apo 1.4% që ishte niveli mesatar vjetor për periudhën 2007-2011.

Numri i operatorëve në tregjet financiare, gjithashtu, pati rritje. Nga 447 operatorë të licencuar në vitin 2012, në vitin 2013 zhvilluan aktivitet 480 operatorë, prej të cilëve 53 të licensuar si shoqëri, 5 fonde pensioni dhe investimi dhe pjesa tjetër të licencuar si individë profesionistë. Gjithashtu, vërehet që po rritet gama e llojit të licencave që jepen, duke treguar prirje për plotësim të tregjeve me operatorë të fushave të ndryshme.

Pra, AMF po mbikëqyr dhe rregullon tregje me dinamikë të lartë zgjerimi.

Në dy vitet e fundit, dhe më e theksuar gjatë vitit 2013, është vërejtur edhe një ndryshim strukturor në tregje. Kështu, në periudhën 2007-2011 tregu i sigurimeve zinte 99% të veprimtarisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në dy vitet e fundit po zgjerohet veprimtaria e fondeve të investimeve dhe më pak e fondeve të pensioneve private. Për herë të parë në vitin 2012 asetet e fondeve të investimeve përbënin pothuaj gjysmën e aktiveve gjithsej të tregjeve financiare. Ndërsa në vitin 2013, fondet e investimeve tashmë renditen si tregu më i madh nisur nga totali i aseteve, me 69% të aktiveve gjithsej të tregjeve financiare.

Pra, AMF po mbikëqyr dhe rregullon jo vetëm tregje me dinamikë të lartë zgjerimi, por edhe tregje me strukturë në ndryshim të shpejtë dhe gjithnjë e më komplekse.

Bazuar në këto zhvillime, për vitin 2013 mund të themi se nisi një cikël i ri për AMF-në në ushtrimin e funksioneve të veta të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në këtë kuadër, veprimtaria rregulluese dhe mbikëqyrëse e Autoritetit po riformatohet për t'iu përshtatur rritjes sasiore të aktivitetit të tregjeve, rritjes së kompleksitetit, si dhe ndryshimit të profilit të risqeve të tyre.

Ndryshimet që po pësojnë tregjet nën mbikëqyrje kanë konturuar strategjinë afatmesme të AMF-së në drejtim të tregjeve, të objektivave të punës, si edhe të forcimit të kapaciteteve administrative të Autoritetit. Suksesi në zbatimin e kësaj strategjie do të varet gjerësisht nga

² Referohemi si vlerësime, sepse të dhënat përfundimtare do të raportohen pasi të jenë audituar pasqyrat financiare të subjekteve të mbikëqyrura.

mbështetja që do të gjejë AMF në nismat e veta në drejtim të forcimit institucional, nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe rritjes së përgjegjshmërisë; të miratimit të paketave ligjore të prezantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë; si dhe të zbatimit të strategjive të hartuara me asistencën e ekspertëve të huaj për stabilizimin dhe nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje.

Strategjia afatmesme e Autoritetit mbështetet në rekomandimet e dhëna nga Raporti i Progresit të KE-së dhe nga misioni i përbashkët i Bankës Botërore (BB) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në kuadër të programit të vlerësimit të sektorit financiar (misioni FSAP). Këto rekomandime shtrihen në të tre tregjet e mbikëqyrura nga AMF dhe synojnë stabilizimin dhe nxitjen e zhvillimit.

Për **tregun e sigurimeve** tashmë është miratuar paketa e *masave stabilizuese*, ku përfshihen: rivendosja menjëherë e financimit të fondit të kompensimit, duke u kërkuar shoqërive të sigurimit të financojnë detyrimet e papaguara, si dhe vendosja e kërkesave për mbajtjen dhe financimin e një rezerve monetare, në llogari qëllimore që mund të përdoret vetëm për pagesat e dëmeve.

Për **tregun e fondeve private të pensionit**, rekomandimet kryesore kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF dhe forcimin e institucionit, si parakusht për të ndërmarrë reformën në kolonën e dytë të pensioneve dhe për të nxitur zhvillimin e kolonës së tretë.

Për **fondet e investimit**, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm i transparencës dhe komunikimit të informacionit për investitorët, si dhe forcimi i rregullave për administrimin e riskut, duke u bazuar në direktivat e BE dhe standardet e IOSCO-s.

Si *masa më afatgjata* rekomandohen *nxitja e zhvillimit të tregut të sigurimeve* nëpërmjet prezantimit të kërkesave për sigurim të përgjegjësive në shërbime të ndryshme profesionale apo të sigurimit të rreziqeve nga katastrofat, heqjes së TVSH-së nga produktet e sigurimeve jo të detyrueshme, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes me fokus riskun.

Sfida më e madhe mbetet zbatimi i rekomandimeve për forcimin e kapaciteteve administrative të Autoritetit. Si Raporti i Progresit i KE-së ashtu edhe misioni i FSAP përcaktojnë forcimin e pavarësisë së Autoritetit, sidomos asaj financiare dhe operacionale, si mekanizmin e përshtatshëm që do të çojë në forcim të kapaciteteve mbikëqyrëse. Bazuar në këto rekomandime u përgatit një paketë ligjore, si pjesë e kushteve të marrëveshjes për modernizimin e sektorit financiar me BB dhe FMN. Kjo paketë ligjore është miratuar nga Qeveria dhe pritet diskutimi në legjislativin shqiptar. Për këtë çështje, AMF ka nevojë të gjejë mirëkuptim dhe vullnet të mirë për miratimin e kësaj pakete, si një ndër premisat për rritjen e efektivitetit të procesit mbikëqyrës

dhe rregullator, zbatimin e mbikëqyrjes me bazë riskun, nxitjen e zhvillimit të tregjeve, si dhe forcimin e mbrojtjes konsumatore.

2. Nxitja e qëndrueshmërisë financiare

Këto problematika të sektorit financiar në Shqipëri janë trajtuar në Grupin Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF), pjesë e të cilit është AMF. Në vitin 2013 janë diskutuar çështje që lidhen me sigurimin e detyrueshëm motorik, përfshi edhe kartonin jeshil, dhe lidhjen me qëndrueshmërinë financiare të tregut financiar në tërësi. AMF ka prezantuar strategjinë e mbikëqyrjes me fokus riskun për tregun e sigurimeve, si tepër të domosdoshme në rrethanat që tregu ndodhet aktualisht, duke marrë njëkohësisht mbështetje nga anëtarët e GKSF, për miratimin e paketës së ligjeve, si shtysa kryesore për fillimin e zbatimit të metodologjisë me fokus riskun, e cila është hartuar me asistencën e BB. Bazuar në rekomandimet e lëna nga GKSF, në kuadër të qëndrueshmërisë financiare, në qershor 2013, AMF konceptoi një strategji për administrimin e situatave të jashtëzakonshme, e cila u hartua me asistencë nga FSVC me ekspertë të BAFin, Gjermani.

Duke u ndalur në veçanti në secilin prej tregjeve do të theksoja:

3. Tregu i sigurimeve

Tregu i sigurimeve, në vitin 2013, në tërësinë e tij, ka paraqitur një **situatë të ngjashme me atë të vitit 2012**, ku problematika kryesore ka vijuar të jetë tregu i sigurimit të detyrueshëm motorik. Totali i aktiveve është zgjeruar me 7% kundrejt vitit 2012, duke ruajtur pak a shumë ritmin mesatar vjetor të rritjes prej vitit 2010. Ndërsa në krahasim me totalin e aktiveve të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, ky treg zë vetëm 30%, duke i renditur i dyti pas fondeve të investimeve, dhe numri i operatorëve ka mbetur i pandryshuar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto ka pësuar tkurrje. Në vitin 2013 vëllimi arriti në 8.5 miliardë lekë, duke u ulur me afro 4.6% krahasuar³ me vitin 2012. Edhe *në strukturën e tregut nuk vërehen ndryshime.* Sigurimet e jo-jetës përbëjnë 88.1% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto në këtë treg dhe 54.7% e përbëjnë ato vullnetare. Primet e shkruara bruto të jo-jetës gjatë vitit 2013 u ulën me 6.5% krahasuar me vitin 2012, kryesisht si rrjedhojë e luhatjes, me tendencë në ulje, të çmimit të produktit MTPL. Sikurse u konkludua edhe nga analizat e kryera nga ekspertët e misionit FSAP, tregu i sigurimeve është përfshirë në një konkurrencë të ashpër, gjë që është pasqyruar me luhatjet e vazhdueshme të primit të shitjes së produktit MTPL.

Duke iu referuar ecurisë së primit të aplikuar dhe primit të rrezikut, në harkun kohor shator 2011 – mars 2014, vihet re që në *53% të këtij harku kohor tarifat janë aplikuar nën vlerën e primit të*

³ Krahasimi është bërë me shifrat e raporteve të audituara të vitit 2012.

rrezikut. Në periudhën menjëherë pas liberalizimit, shtator 2011 – janar 2012, nënvlerësimi i primit të aplikuar ka arritur deri në 50%, i pasuar nga një periudhë 10-mujore stabilizimi, e cila u shoqërua nga një tjetër periudhë luhatjesh, në muajt mars – prill 2013, gjatë të cilës konstatohet nënvlerësimi arriti deri në 60%.

Primi i rrezikut është pjesa e primit të sigurimit e vlerësuar për të mbuluar dëmet sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sigurimit, si dhe për të financuar kontributin e shoqërisë së sigurimit në fondin e kompensimit. Tarifatat e kontratave të sigurimit (primi i sigurimit) përbëhen nga primi i rrezikut, të cilit i shtohet pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve administrative, si dhe pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë.

Tarifimi i vazhdueshëm nën nivelin e primit të rrezikut ka cenuar ndjeshëm likuiditetin dhe përfitueshmërinë e siguruesve, duke vënë në rrezik shëndetin financiar të tyre dhe për rrjedhojë cilësinë e procesit të shlyerjes së detyrimeve ndaj të siguruarve. Autoriteti, në bashkëpunim dhe me ekspertët e Bankës Botërore ka përforcuar kërkesat rregullatore për provigjoni e kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke përcaktuar si vlerë minimale vlerat e primit të rrezikut të përlllogaritura nga Autoriteti në nivel tregu, pavarësisht çmimit të shitjes nga siguruesit.

Sikurse e kam theksuar në raportimin e vitit 2012, problematikat me Byronë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) dhe në veçanti me ecurinë e financimit të fondit të kompensimit, si dhe dëmet subjekt i këtij fondi, janë trajtuar me përparësi nga ana e Autoritetit.

Detyrimet për pagesat e dëmeve të papaguara, subjekt i fondit të kompensimit, kanë pësuar rritje të ndjeshme. Në këtë drejtim, përveç numrit të lartë të mjeteve të pasiguruara në qarkullim, që në fund të vitit 2013 vlerësohej rreth 27% të mjeteve të regjistruara⁴, kanë ndikuar edhe vonesat në kryerjen e pagesave, si dhe administrimi jo efektiv i BSHS. Kështu, *detyrimet për dëmet e papaguara në tre vitet e fundit janë dyfishuar*, nga 609 milionë lekë në vitin 2011 në 1.3 miliardë lekë në vitin 2013. Efekti që dëmet e paguara nga FK gjatë vitit 2013 kanë në raportin dëme/prime të tregut vlerësohet rreth 4.6%.

Për këtë arsye, vendimet e AMF-së të vitit 2013 në lidhje me FK përcaktuan një nivel mjaft më të lartë fondi, si dhe përcaktuan njohjen përkatëse të detyrimeve për dëmet e mbetura pezull. Në vijim të këtyre vendimeve, në vitin 2014 janë ndërmarrë masa stabilizuese për tregun e produktit MTPL dhe po ndiqet në vijimësi zbatueshmëria e tyre. Kështu, masa stabilizuese për financimin e fondit të kompensimit, përcakton shlyerjen tërësore të detyrimeve të prapambetura brenda një periudhe trevjeçare, 2014-2016. Vetëm për vitin 2014, fondi për shlyerjen e detyrimeve për dëme pezull deri më 31.12.2013, është përcaktuar në masën 430 milionë lekë. Kjo nënkupton që *masa e fondit në dispozicion të pagesës së dëmeve për periudhën 2012-2014 është trefishuar*.

⁴ Treguesi llogaritet duke u bazuar në numrin e automjeteve në qarkullim, sipas DPSHTR, që për 31 dhjetor 2013 është 445,956 dhe numrin e policave të vlefshme, që është 325,929.

Përveç nivelit të fondit të kompensimit, masa stabilizuese parashikon edhe kryerjen e pagesave sipas rendit kronologjik të ndodhjes së ngjarjes. Pra, më parë do të kryhen pagesat që shkojnë për shlyerjen e dëmeve të shkaktuara nga ngjarjet më të hershme të sigurimit. Gjithashtu, për të ndjekur zbatueshmërinë e vendimit për pagesat e dëmeve pezull, AMF ka ndërtuar një sistem mujor monitorimi të treguesve, do të ndjekë gjithë procesin e ndarjes së praktikave dhe të zbatimit të planit të pagesave për secilën shoqëri sigurimi. Gjithashtu, për një proces transparent dhe për mospërsëritje të situatës së kaluar, për dëmet në lidhje me ngjarjet e sigurimit të ndodhura gjatë vitit 2014 e në vijim është krijuar një tjetër fond, veçmas fondit për dëmet e prapambetura, në masën 20 milionë lekë. Njëherësh u mor masa stabilizuese për krijimin dhe mbajtjen e rezervës monetare për produktin MTPL, e shoqëruar me një sistem mujor monitorimi, me qëllim që për dëmet e reja të sigurohet shlyerja në kohë e tyre.

Aspekti tjetër që ka kërkuar vëmendjen e AMF-së është vendosja në monitorim e BSHS, nga Këshilli i Byrove Bruksel, (COB). Vendimi u mor si rrjedhojë e performancës së ulët në treg dhe rritjes së numrit të thirrjeve të garancive (nga 51 në 2010, 80 në 2011, 82 në 2012 dhe 111 në 2013). Për rrjedhojë, për BSHS u përcaktuan edhe kushtet për t'u plotësuar, të cilat kryesisht konsistojnë në: *risigurimin* të një broker i përzgjedhur dhe kontrata e risigurimit është lidhur në përputhje me rekomandimet e COB dhe në *vendosjen e garancisë bankare* në Bruksel në favor të Këshillit të Byrove, për të garantuar pagesat. Aktualisht BSHS informon periodikisht Këshillin e Byrove për stabilitetin e tregut të sigurimit motorik si dhe pagesat e menjëhershme të dëmeve që rrjedhin nga kontrata e sigurimit karton jeshil.

Një risi në procesin mbikëqyrës në tregun e sigurimeve është edhe përfshirja e AMF-së për herë të parë në kolegjet mbikëqyrëse. Këto janë organizma ku përfaqësohen autoritetet rregullatore nga vende të ndryshme të BE-së për të realizuar mbikëqyrjen e grupeve financiare që ushtrojnë aktivitet në më shumë se një vend. Kapitali austriak në tregun e sigurimeve në Shqipëri ka një peshë të konsiderueshme prej 35%. Për rrjedhojë, AMF ka një marrëveshje dhe marrëdhënie aktive bashkëpunimi me Autoritetin (mbikëqyrës) e Tregjeve Financiare të Austrisë. Përtej marrëdhënies dypalëshe në vitin 2013, AMF u bë pjesë e kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve financiare austriake të pranishme në Shqipëri.

4. Tregu i letrave me vlerë

Aktiviteti i fondeve të investimeve, në lekë dhe në euro, ka dominuar zhvillimin në tregjet financiare, për shkak të zgjerimit të aktivitetit të tyre. Totali i aseteve nën administrim arriti në 50.3 miliardë lekë, përbën 69% të totalit tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në më pak se dy vjet veprimtari numri i anëtarëve të këtyre fondeve është rritur në 28,422, ose është mbi dyfishin e numrit të anëtarëve të një viti më parë (10,962).

Pra, tregu i letrave me vlerë gradualisht po plotësohet me operatorë dhe produkte. Nga ana tjetër, dinamika e zhvillimit të fondeve të investimeve **tregon që nga investitorët vendas ka interes për produkte të reja kursimi apo investimi**. Kjo situatë favorizohet edhe nga mjedisi me norma të ulëta të interesit, që zbatohen për produktet bankare të kursimeve.

Periodha aktuale vlerësohet e favorshme për të nxitur zhvillimin e tregut të kapitaleve në vend, me qëllim që kërkesa e investitorëve për shumëllojshmëri produktesh të këtij tregu të ballafaqohet me një ofertë të përshtatshme të këtyre produkteve. Për më tepër, kriza financiare botërore më e fundit tregoi që tregu i kapitaleve është i nevojshëm për të siguruar financim të ekonomisë, në kushtet kur kreditimi futet në ngërç. Duhet theksuar se **zhvillimi i tregut të kapitaleve nuk mund të jetë përpjekje e izoluar e një institucioni por përbën një detyrë komplekse, që kërkon vullnet dhe bashkëpunim ndërmjet autoriteteve**.

Theksoj që AMF, duke patur në vëmendje që natyrshëm zhvillimet shoqërohen edhe me risqe, ka përgatitur paketën ligjore për ta përshtatur institucionin për mbikëqyrjen e këtij tregu dhe për të forcuar kapacitetet mbikëqyrëse dhe rregullative. Gjithashtu, AMF po bashkëpunon me BSH për të organizuar mbikëqyrjen e konsoliduar për ato segmente të veprimtarisë ku ndërthuren kompetencat mbikëqyrëse.

5. Tregu i fondeve të pensioneve private

Tregu i pensioneve po ashtu ka shfaqur një ritëm të lartë zgjerimi. Gjatë vitit 2013, totali i aseteve neto të fondeve të pensioneve private arriti në 443 milionë lekë, me një rritje prej afro 57%, si dhe një numër anëtarësh prej 7,888 ose 8% më tepër se në vitin 2012.

Megjithatë, ritmet e zgjerimit të tregut këto dy vite shfaqen jo konsistente, për arsye se zhvillimi i tregut nuk mbështetet me nxitësit e përshtatshëm fiskalë, sikundër ndodh në tregjet e tjera, kryesisht ato evropiane. Kufizimet aktuale të përcaktuara në ligjin për tatimet mbi të ardhurat kanë cenuar interesat e shumë individëve që tentuan të futen në skemat e pensionit vullnetar. Në këtë situatë është e domosdoshme që të gjejnë zbatim lehtësitë tatimore për individët që përfshihen në këto skema, ashtu si ato janë parashikuar në Ligjin “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, AMF e konsideron reformën e pensioneve, jo vetëm reformimin e sistemit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore, por të pensioneve private, përkatësisht kolonën e dytë dhe të tretë, si të një rëndësie shumë të madhe. AMF **shpreh gatishmërinë që**, me mbështetjen e të gjithë aktorëve institucionalë dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke ndjekur rekomandimet e FSAP, si dhe duke e harmonizuar me forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse për këtë segment të veçantë të tregut financiar, **të orientojë dhe drejtojë reformën për kolonën e dytë**.

Duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj, vlerësoj të dobishëm çdo diskutim në vijim për këto elemente të rëndësishme të zhvillimit të tregjeve financiare në vend.